

RAPORT

“AKTIVITETI I SHOQËRISË KESH SH.A. PËR VITIN 2021”

Shkurt 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

AKRONIME	3
1. HYRJE	4
2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2021.....	4
2.1 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK	4
2.2 RITJJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË DHE PLANI I EMERGJENCËS	5
2.3 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2021	7
2.4 TREGJET OPERUES DHE KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM	8
3. ÇËSHTJE RREGULLATORE TË LIDHURA ME VEPRIMTARINË E KESH SH.A.....	9
4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM	12
4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI	12
4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE	15
4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE.....	16
4.4 CILËSIA E PRODHIMIT	17
5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2021.....	18
5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK	18
5.2 AKTIVITETI NË TREGUN E RREGULLUAR.....	20
5.3 AKTIVITETI NË TREGUN E LIRË.....	22
6. AKTIVITETI INVESTUES	23
6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2021	23
6.2 INVESTIMET E FINANCUARA NGA PARTNERËT NDËRKOMBËTAR	25
6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA	25
6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE DHE PËRGJEGJSHMËRIA SOCIAL-MJEDISORE	27
7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2021.....	28

AKRONIME

APA	- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të KESH sh.a.
BB	- Banka Botërore
BERZH	- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	- Burimet e Rinovueshme të Energjisë
EIP	- Plani i Investimeve Ekonomike të Bashkimit European në Ballkanin Perëndimor
ERE	- Enti Rregullator i Energjisë
FMF	- Furnizuesi i Mundësisë së Fundit
FTL	- Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
FSHU	- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
HUPX	- Bursa Hungareze e Energjisë
IHA	- Organizata Ndërkombëtare e Hidroenergjisë
KESH	- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., ose në vijim Korporata/Shoqëria
KfW	- Banka Gjermane e Zhvillimit
KOSTT	- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
MFE	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NEMO	- Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike
OST	- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sh.a.
OSHEE Grup	- Grupi Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
OSSH	- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PEF	- Programi Ekonomiko-Financiar i KESH sh.a.
REMIT	- Rregullore për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë
SECO	- Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike i Zvicrës
TU	- Tensioni i Ulët
WBIF	- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor

1. HYRJE

Fillimi i vitit 2021 u karakterizua nga kushte meteorologjike mjaft të favorshme hidrike me reshje intensive, të cilat u reflektuan në rritje të prodhimit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit. Periudha e reshjeve të konsiderueshme që filloi në fund të Dhjetorit 2020, vazhdoi intenzivisht gjatë Janarit-Shkurtit 2021, krijoi një situatë shumë optimale hidrike, duke reflektuar aktivitetet të lartë operues dhe prodhim të lartë të energjisë elektrike. Mjaftojnë vetëm disa shifra për ilustrim:

- Sasia e reshjeve të rëna regjistruar në basenin e lumit Drin për Janar 2021 ishte 579 mm, ose gati 3.3 herë më e lartë se mesatarja shumëvjeçare për këtë muaj;
- Prodhimi i energjisë për periudhën 2 mujore Janar-Shkurt 2021, ka regjistruar vlerën mbi 1,312 GWh, ose rreth 60% më shumë se mesatarja shumëvjeçare e prodhimit për periudhën respektive;
- Prurjet mesatare në kaskadë, gjatë Janarit arritën 1,271 m³/s, më të lartat të regjistruara që nga 1990;
- Frekuencë e lartë me prurje më të mëdha se 1,800 m³/s, vetëm në Janar plot 8 të tilla;
- Piku i prurjeve natyrore në kaskadë 4,673 m³/s, më i larti i regjistruar ndonjëherë.

Ndërkohë përveç gjenerimit, Korporata u kujdes maksimalisht për administrimin sa më efektiv dhe të kujdesshëm të reshjeve dhe prurjeve të mëdha, duke treguar vëmendjen maksimale për shmangien e përmbytjeve në zonën e ultësirës Shkodrës-Lezhë.

Si rezultat u arrit që mbi 1 miliard m³ ujë (ose 34% e prurjeve), të mbahen në kaskadë si rezervë energjitike. U shkarkuan vetëm 20% e prurjeve pik natyrore në kaskadë dhe shkarkimet nga portat e HEC Vau i Dejës rezultuan jo më shumë se 900 m³/s, duke eliminuar impaktin mjedisor në zonat e banuara të ultësirës Shkodër-Lezhë.

Situata e përballua me sukses falë koordinimit të strukturave të Korporatës në bashkëpunim me ekspertët e Sekretariatit Teknik dhe Komisionit të Posaçëm të Trajtimit të Plotave.

2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2021


2.1 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK

Si rezultat i situatës së favorshme hidrike, sidomos në pjesën e parë të vitit 2021, Korporata arriti me sukses të plotësojë objektivat e saj që konsistuan në:

- Rritjen e sigurisë së furnizimit të pandërprerë me energji elektrike për detyrimin për shërbimin publik;
- Ofrimin në kohë dhe me cilësinë e duhur të shërbimeve të balancimit dhe atyre ndihmëse;
- Aktivitetet dinamik tregtar, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme operative, që ndikuan pozitivisht edhe në qëndrueshmërinë ekonomike të Korporatës.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të aktivitetit të shitjes së energjisë dhe shkëmbimit, krahasuar me planin e miratuar fillestar për 2021:

Grafiku 1. Shitje Energjie-Realizim 2021 vs PEF i Miratuar 2021



Referuar grafikut më lart gjatë vitit 2021, KESH arriti të plotësojë me sukses detyrimin për shërbimin publik, të zhvillojë një aktivitet dinamik tregtar dhe ndërkohë të siguroj aktivitet thelbësor të shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit, duke tejkaluar pritshmëritë e PEF të miratuar fillestar 2021.

Aktiviteti i shtuar prodhues dhe tregtar, siguroi një rezultat të kënaqshëm operativ ekonomik-financiar, i cili në shifra të përgjithshme agregate dhe i krahasuar me PEF të miratuar fillestar 2021, pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 2. Të ardhura/Shpenzime - Realizim 2021 vs PEF i Miratuar 2021




Referuar grafikut më lart, të ardhurat nga aktiviteti operativ 2021 rezultuan 18.9 Mld. Lekë ose rreth 2.35 herë më të larta se Plani i Miratuar fillestar, duke siguruar një rezultat para tatimit prej 8.48 Mld. Lekë, duke mbështetur konsolidimin financiar dhe planet investuese të Korporatës.

2.2 RITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË DHE PLANI I EMERGJENCËS

Si rezultat i rritjes së kërkesës për energji shkaktuar si kombinim i rritjes së aktivitetit global ekonomik post-pandemik dhe situatave gjeopolitike, shkaktuan një rritje të çmimeve të lëndëve djegëse dhe veçanërisht të gazit natyror. Kjo rritje ndikoi në rritjen e çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare dhe sidomos në tregun evropian. Më poshtë paraqitet grafikisht kurba e çmimit mesatar mujor të energjisë, sipas Bursës Hungareze (HUPX) në mbyllje pozicioni (ATC-At The Close Order).

Grafiku 3. Çmimi mesatar mujor 2021-HUPX



Sipas grafikut, rritja e ndjeshme konstante, filloi në Shtator 2021, për të arritur në Dhjetor në nivelin mesatar 245.81 Eur/MWh.

Në përgjigje të kësaj situate dhe ndërmarrjes së masave përkatëse, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.584, datë 08.10.2021, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike e cila i shtrin efektet deri në dt. 15 Prill 2022, duke vendosur ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, pezullimin e planeve të investimeve përveç atyre më të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë për shoqëritë “KESH sh.a.”, “OST sh.a.” dhe “OSHEE Group sh.a.”.

Nga ana tjetër, sipas këtij vendimi, këto shoqëri do të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e MIE, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.

- Në vijim dhe zbatim të Vendimit nr.584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe përballimin e parandalimit e saj”, me ndryshimin përkatës Vendimin nr.757, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave.

Sipas këtij vendimi, FSHU-së, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga KESH sh.a. KESH sh.a furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e FSHU-së, KESH sh.a ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë.

Sipas kësaj VKM-je, KESH sh.a do të kryejë veprime shitjeje energjie dhe depozitimi/shkëmbimi vetëm pasi plotëson të gjitha nevojat e furnizimit të FSHU si edhe OSSH, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e saj.

Po sipas këtij vendimi, sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga KESH sha, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, i shitet OSSH për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit të shitjes së prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike nga burime hidrike, me kapacitet të instaluar deri në 15 MW, në periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet.

KESH sh.a. për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitim të shkëmbimit të tepërcave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e FSHU. KESH sh.a. ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cenon sasi të nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

Nëpërmjet procesit të depozitimit/shkëmbimit, KESH sh.a depoziton/shkëmbejnë tepërcat e energjisë të destinuara për shitje në tregun e lirë, me qëllim që:

- a) të maksimizojë prodhimin e energjisë elektrike nga kaskada dhe të optimizojë përdorimin e prurjeve për prodhim, për të evituar shkarkimet e ujit pa prodhuar energji elektrike dhe duke krijuar njëkohësisht rezervë energjie për periudhën e thatë të vitit;
- b) të garantojë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve kontraktore;
- c) të rrisë fleksibilitetin teknik për të siguruar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik;
- d) të minimizojë dhe/ose të parandalojë ndikimet potenciale social-mjedisore.

2.3 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2021

Aktiviteti vjetor operativ u zhvillua bazuar në Programin Ekonomiko-Financiar 2021 miratuar me Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë Nr. 135; datë 14.01.2021. Si rezultat i situatës së favorshme hidrike gjatë pjesës së parë të 2021, ky program u rishikua dhe u miratua me vendimin e APA Nr. 5755/1; datë 26.07.2021.

Ndikuar nga gjendja e emergjencës, nga rritja e ndjeshme e çmimeve të energjisë, në zbatim të masave për përballimin e saj, Programi i Ekonomiko-Financiar 2021, u rishikua përsëri dhe u miratua me Vendimin e APA Nr.5755/3, dt.19.11.2021. Më poshtë paraqitet PEF i Miratuar 2021 dhe PEF i Rishikuar II 2021 dhe krahasimi ndërmjet tyre.

Tabela 1. PEF i Miratuar 2021 i KESH sh.a. dhe Rishikimi II 2021

<i>Pasqyra Operacionale Ardhura-Shpenzime (shumat janë të shprehura në mijë lekë)</i>	Njësia	PEF 2021 (i miratuar)	PEF 2021 (i Rishikuar II)	Ndryshimi në Vlerë (PEF i Rishikuar II - PEF i Miratuar)	Ndryshimi në % (PEF Rishikuar II - PEF i Miratuar)
Totali i Prodhimit Neto KESH	MWh	3.975.497	5.320.988	1.345.492	33,84%
<i>Energji e tregtuar për furnizim OSHEE-Klientë Tariforë</i>	"	3.950.000	4.124.538	174.538	4,42%
<i>Energji e tregtuar në tregun e parregulluar (përfshirë dhe shërbimet e balancimit)</i>	"	25.497	1.196.450	1.170.954	4592,59%
Të Ardhura gjithsej	(000) lekë	8.070.330	18.267.313	10.196.983	4018,27%
<i>Shitjet e Energjisë për klientët tariforë të OSHEE</i>	"	5.925.000	8.120.772	2.195.772	37,06%
<i>Çmimi i shitjes</i>	lekë/kWh	1,5	1,5		
<i>Shitjet e Energjisë për mbulimin e humbjeve të OSHEE</i>	(000) lekë	0	0	0	0,00%
<i>Shitjet e Energjisë për humbjet e Transmetimit OST</i>	"	0	810.240	810.240	100,00%
<i>Shitjet e Energjisë për humbjet e Transmetimit KOSTT</i>	"	0	26.562	26.562	100,00%
<i>Shitjet e Energjisë me çmime tregu dhe optimizim (eksport dhe tregu vendas)</i>	"	1.189.489	6.538.161	5.348.672	449,66%
<i>Shitje Energjie për mbulimin e Dësbancave</i>	"	3.258	101.272	98.014	3008,48%
<i>Të Ardhura të Tjera (Shërbime ndihmëse)</i>	"	817.483	2.478.097	1.660.614	203,14%
<i>Të ardhura të tjera</i>	"	0	30.180	30.180	100,00%
<i>Të ardhura financiare</i>	"	135.099	162.028	26.929	19,93%
Shpenzime gjithsej	(000) lekë	7.949.924	10.337.347	2.387.423	30,03%
<i>Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu dhe optimizim (import dhe tregu vendas)</i>	"	921.295	191.348	-729.947	-79,23%
<i>Kompensimi financiar për OSHEE për sasinë e energjisë të munguar</i>	"	0	1.233.588	1.233.588	100,00%
<i>Tarifë Transmetimi</i>	"	6.810	5.618	-1.192	-17,50%
<i>Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	"	727	120.391	119.664	16453,89%
<i>Blerje të Tjera (Shërbime ndihmëse)</i>	"	18.895	511.792	492.898	2608,68%
<i>Shpenzime Personeli</i>	"	1.530.828	1.309.716	-221.112	-14,44%
<i>Materiale të para dhe të konsumueshme</i>	"	208.495	154.894	-53.601	-25,71%
<i>Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi</i>	"	2.967.120	3.618.459	651.339	21,95%
<i>Furnitorë dhe Shërbime</i>	"	1.346.400	1.095.337	-251.064	-18,65%
<i>Shpenzime të tjera</i>	"	104.971	1.507.343	1.402.372	1335,97%
<i>Shpenzime financiare</i>	"	844.383	588.861	-255.522	-30,26%
<i>Shpenzime tatim fitimi</i>	"	18.061	1.189.495	1.171.434	6486,04%
Fitimi / (Humbja) neto	"	102.345	6.740.471	6.638.126	6486,04%
Numri Mesatar i Punonjësve	Nr.	765	765	0	0%
Paga Mesatare	lekë/muaj	87.507	87.507	0	0%
Invesime gjithsej	(000) lekë	6.362.266	5.259.539	-1.102.727	-17,33%
Nga këto:					
<i>Fonde të huaja (Projekti i Sigurisë së Digave)</i>	(000) lekë	1.974.155	1.602.596	-371.559	-18,82%
<i>Fondet e veta të shoqërisë</i>	"	4.388.111	3.656.943	-731.168	-16,66%
<i>Projekte lokale</i>	"	4.049.700	3.388.364	-661.336	-16,33%
<i>Projekti i Sigurisë së Digave</i>	"	338.411	268.579	-69.832	-20,64%

2.4 TREGJET OPERUES DHE KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM

Gjatë vitit 2021, KESH sh.a. zhvilloi aktivitetin në dy nivele tregu operimi:

A. Aktiviteti në tregun e rregulluar:

- Furnizim/shitje e energjisë elektrike shoqërisë FSHU sh.a. në kuadër të furnizimit me energji elektrike të klientëve fundorë me çmim/njësi dhe sasi vjetore të miratuar nga Asambleja e Shoqërisë sh.a. me Vendimin Nr. 135, datë 14.01.2021 "Për miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021 dhe parashikimi për 2022-2025" rishikuar me vendimin Nr. 5755/1; dt.26.07.2021. Furnizimi është i rregulluar sipas kontratës tip të miratuar nga palët me Nr. 2920/1; datë 24.09.2020 dhe rishikuar/miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 4, datë 15.01.2021;
- Furnizim/shitje e energjisë elektrike shoqërisë FSHU sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Marrëdhënia për këtë produkt vazhdoi sipas kushteve të kontratës Nr.2264, datë 13.05.2019, miratuar nga Bordi i ERE me vendimin Nr. 122; datë 29.07.2019 dhe i lënë në fuqi po nga ERE edhe për vitin 2021 me anë të vendimit të këtij të fundit Nr. 20; datë 20.01.2021;
- Ofrimi i shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të rrjetit të transmetimit sipas kontratës ekzistuese (2018 e në vijim), për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjetik me shoqërinë OST sh.a., miratuar nga Bordi i ERE me vendim Nr. 84; datë 31.05.2019, e cila rregulloi marrëdhëniet edhe gjatë 2020. Ndërkohë për periudhën aktuale (2021) kjo zgjatje e efekteve u miratua me Vendimin nr.51, datë 17.02.2021, të Bordit të ERE-s. Gjithsesi këto rregulla ishin të përkohshme deri në hyrjen e fuqi të rregullave të përhershme të balancimit, të bëra efektive nga 01 Prill 2021.

B. Aktiviteti në tregun e parregulluar:

- Shitje e energjisë elektrike shoqërisë OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, nëpërmjet pjesëmarrjes dhe ofrimit të çmimit të shitjes në procedurat e blerjes të zhvilluara nga ana kjo shoqëri;
- Shitje e energjisë elektrike nëpërmjet procedurave të zhvilluara nga shoqëria në kushte e një sate të favorshme hidrike dhe mbajtjen e niveleve optimale të shfrytëzimit në rezervuarët e kaskadës;
- Edhe gjatë 2021, është konsoliduar ofrimi i produkteve të energjisë për tregun e Kosovës dhe konkretisht me KOSTT, si shitja e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet e balancimit (kapacitetit rezervë), si hapa konkret që synojnë shtrirjen në rajon të aktivitetit të Korporatës.

C. Komercializimi i mëtejshëm të aktivitetit

- Me datë 1 Prill 2021 hynë në fuqi rregullat e reja përhershme të balancimit, ku dhe KESH sh.a. nuk e ka më detyrim për të dhënë këtë shërbim siç ishte përcaktuar në rregullat e përkohshme të balancimit ku Korporata ishte i vetmi subjekt që do të ofronte këtë shërbim.
- Nga data 1 Prill, KESH sh.a. si dhe ofruesit e tjerë të kualifikuar për këtë shërbim, hynë në ankandet javore të angazhimit për disponueshmëri. Në varësi të kapacitetit të kualifikuar në këtë ankand, KESH sh.a. ofron çdo ditë të javës për ditën D+1 çmimin për energjinë balancuese duke ju referuar trendit të çmimit të bursave të rajonit për ditën në avancë shumëzuar me një koeficient të përcaktuar sipas përllogaritje të kryera nga Drejtoria e Operacioneve Tregtare.
- Po kështu KESH sh.a dhe HUPX kanë nënshkruar marrëveshjen "HUPX GROUP Info User Agreement", ku KESH sh.a. në kohë reale do të marrë informacion LIVE DATA për çmimet që realizohen dhe ato të pritshme për periudhën në avancë.
- Nga data 1 Prill, KESH është duke ofruar shërbimin e balancimit me shoqërinë Energji Ashta sh.p.k. duke u bërë Grup Balancimi. Kjo marrëveshje erdhi në kushtet ku njësite prodhuese të shoqërisë Ashta

janë në rrjedhën e fundit të kaskadës së Drinit dhe ku rezervuari i tij ushqehet nga Hidrocentrali i Vaut të Dejës dhe nga disa prurje të vogla anësore.

- Në tregun rajonal, është për tu përmendur vazhdimësia e aktivitetit komercial me KOSTT duke ofruar konkretisht shërbimet ndihmëse/aktivizim rezerve (sipas kontratës dypalëshe Nr. 2132; dt.24.12.2020), si dhe shitjet për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit të Kosovës, të cilat afirmojnë potencialin dhe aftësitë tregtare të Korporatës edhe në rang rajonal.

Gjendja e përkohshme e emergjencës e shfaqur në 3-mujorin e fundit të vitit 2021 dhe në vazhdim deri më 15 Prill 2022, kufizon aktivitetin në tregun e lirë të tregtimit të sasive të energjiave elektrike të tepërta, pasi Koporata do të duhet të furnizojë/lëvrojë energjinë për shoqërinë FSHU, në përmbushje të detyrimit të shërbimit publik për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit.

Por në krahun tjetër, dalja në treg të lirë e klientëve të nivelit TU në mesin e vitit 2022, çel mundësi të mëdha komercializimi nëpërmjet furnizimit për këtë kategori klientësh dhe njëkohësisht do të ulë edhe peshën e detyrimit për shërbim publik të Korporatës.

3. ÇËSHTJE RREGULLATORE TË LIDHURA ME VEPRIMTARINË E KESH SH.A.

Gjatë vitit 2021, ngjarja më e rëndësishme në fushën rregullatore të Sektorit Elektroenergetik është hyrja në fuqi nga dt. 01.04.2021 e rregullave të reja të përhershme të balancimit, të miratuara nga Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 106, datë 02.07.2020. Për rrjedhojë, KESH sh.a. çlirohet dhe nuk e ka më detyrim për të dhënë këtë shërbim siç ishte përcaktuar në rregullat e përkohshme të balancimit ku Korporata ishte i vetmi subjekt që do të ofronte këtë shërbim. Ky është një hap i rëndësishëm drejt liberalizimit të tregut të balancimit të sistemit, duke e ofruar këtë shërbim në termat e tregut të lirë dhe formaton operatorët e tregut si palë përgjegjëse ndaj këtij shërbimi. Në këtë kuadër, i rëndësishëm është edhe vendimi i mëposhtëm mbi rregullimin e këtij shërbimi:

Vendimi Nr.89, datë 31.03.2021, i Bordit të ERE, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi që Rregullat e reja të Tregut Shqiptar të Balancimit të hyjnë në fuqi në datën 1 Prill 2021 por me disa rregullime të përkohshme si p.sh.:

1. OST sh.a. të vijojë procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në tregun e balancimit me formularët e pandryshuar sikurse është vepruar gjatë periudhës Dry Run;
2. Mekanizmi i garancisë financiare që OST sh.a., do të aplikojë për pjesëmarrësit në tregun e balancimit të jetë ai i përcaktuar në Rregullat e Mekanizimit të Përkohshëm të Balancimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 193, datë 24.11.2017;
3. Për periudhën deri në 30 Qershor 2021, periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, të kryhet me interval kohor prej 1 orë;
4. Shoqëria OST sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

Vendime të tjera ligjore/rregullatore të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë dhe implikojnë veprimtarinë e shoqërisë KESH sh.a. të miratuara gjatë këtij viti, përmbledhtazi janë si më poshtë:

Vendimi Nr.4, datë 15.01.2021, i Bordit të ERE-s “Mbi kërkesën e FSHU sh.a për disa ndryshime në “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a për furnizimin e klientëve fundorë”.

Bordi i ERE-s, bazuar në kërkesën dhe propozimet e FSHU-së por edhe disa nga propozimet e përbashkëta të KESH sh.a dhe FSHU sh.a të bëra që në vitin 2020 në lidhje me kontratën e furnizimit për vitet 2020 dhe 2021, miratoi disa ndryshime në këtë kontratë sipas të cilave KESH sh.a nuk do të jetë subjekt i kompensimit financiar në rast pamundësie prodhimi dhe furnizimi dhe kjo pamundësi prodhimi

si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji.

Vendimi Nr.20, datë 20.01.2021, i Bordit të ERE-s “Mbi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE Nr.122, datë 29.07.2019 “Mbi miratimin e draft kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., “Për shit-blejen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”.

Me anë të këtij vendimi Bordi i ERE-s la në fuqi edhe për periudhën në vazhdim 2021, Vendimin Nr.122, datë 29.07.2019, të saj “Mbi miratimin e draft kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., për shit-blejen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019” deri në paraqitjen e draft-kontratës së re nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. dhe miratimin e saj nga Bordi i ERE.

Vendimi Nr.51, datë 17.02.2021, i Bordit të ERE “Mbi miratimin e kontratës ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi zgjatjen e efekteve juridike të Vendimit të Bordit të ERE Nr.184, datë 20.08.2018 “Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjetik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018 ”midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, kontratë e cila do të shtrijë efektet nga data 1 Janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të bordit të ERE, nr. 106, datë 02.07.2020, për “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”.

Vendimi Nr.74, datë 12.03.2021, i Bordit të ERE-s “Për miratimin e objektivave strategjike të ERE-s për periudhën 2021- 2023”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE ka miratuar objektivat strategjike të ERE-s për periudhën kohore 2021- 2023, ndër të cilat më të rëndësishmet janë ato lidhur me mbrojtjen e konsumatorit si edhe zhvillimit transparent dhe efikas të tregjeve të sektorit të energjisë elektrike si edhe të gazit natyror si dhe integritet rajonal të tyre. Në këtë kuadër, edhe KESH sh.a. do të ketë detyrime shtesë dhe rigorozë në lidhje me transparencën dhe moslejimin e abuzimeve, krijimin e kushteve konkurruese, dhënien e informacionit në lidhje me transaksionet energjetike që kryhen etj.

Vendimi Nr.77, datë 19.03.2021, i Bordit të ERE-s “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.

Bazuar mbi kërkesën e OST sh.a., Bordi i ERE-s filloi procedurën për miratimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195.

Në këtë kuadër, edhe KESH sh.a., natyrisht në mënyrë indirekte si ofruesi më i madh i shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit në tregun shqiptar të energjisë elektrike, ka detyrime të rëndësishme lidhur me zbatimin e këtyre rregullave.

Vendimi Nr. 108, datë 22.04.2021, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.

Bazuar mbi kërkesën e OST sh.a., Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.77, datë 19.03.2021 filloi procedurën për miratimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195. Sipas këtij vendimi, kostot e krijuara si rezultat i devijimeve nga vlerat nominale do t'i faturohen palëve përgjegjëse për balancimin në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 106, datë 02.07.2020.

Në këtë kuadër, edhe KESH sh.a., ka të drejta dhe detyrime në lidhje me këto kosto balancimi në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të balancimit.

Vendimi Nr. 126, datë 17.05.2021, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë / REMIT”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi Miratimin e “Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë” (REMIT).

Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë transpozon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

Në këtë kuadër, KESH-it si tregtuesi më i madh me shumicë i energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë ka mjaft angazhime në lidhje me zbatimin e këtyre rregullave në drejtim të detyrimeve për të dhënë dhe publikuar informacionet e kërkuara nga autoritetet dhe subjektet përkatëse.

Vendimi Nr. 142, datë 15.06.2021, i Bordit të ERE “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2021”.

Ky vendim ka efekt edhe mbi KESH-in, si shoqëri e licencuar në tregun shqiptar të energjisë elektrike ka detyrimin që për vitin 2021 të kryejë pagesën rregullatore sipas licencave që zotëron, përkatësisht: Licenca për Prodhim në vlerën 15,540,864 Lekë; Licenca për Tregtim në vlerën 979,324 Lekë dhe Licenca për Furnizim 100,000 Lekë. Ndërsa TEC Vlorë sh.a ka një detyrim pagese rregullatore për Licencë Prodhimi prej 100.000 Lekë.

Vendim Nr. 155, datë 30.06.2021 i Bordit të ERE “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., për zgjatjen e periudhës kohore, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr. 89, datë 31.03.2021 “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi që me kërkesën e shoqërisë OST sh.a., të zgjasë periudhën kohore të parashikuar në pikën 3, të vendimit të bordit të ERE-s nr.89, datë 31.03.2021, duke përcaktuar konkretisht që deri në datën 31 Dhjetor 2021, nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 orë si edhe detyrimin e shoqërisë OST sh.a., që të raportojë në ERE çdo 2 (dy) muaj lidhur me ecurinë e procesit të përshtatjes së platformës IT, si dhe të nominimeve dhe llogaritjeve të disbalancave me interval kohor prej 1 orë.

Vendim Nr. 160, datë 02.07.2021 i Bordit të ERE-s “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e Kodit të Transmetimit”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE filloi procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të ri të Transmetimit, të propozuar nga shoqëria OST sh.a.

Vendim Nr. 255, datë 21.12.2021 i Bordit të ERE-s “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi pranimin e pjesshëm të propozimeve të shoqërisë OST sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, duke ndryshuar rregullat në lidhje me përcaktimin e masës së garancive financiare të pjesëmarrësve të tregut shqiptar të balancimit si edhe vendosi gjithashtu që të shtyjë deri në datën 15 Prill 2022 që d.m.th. që nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave deri në këtë datë, të kryhen me interval kohor prej 1 orë si edhe detyrimin që përgjatë periudhës së gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike sipas VKM nr. 584, datë 22.10.2021, OST sh.a. të raportojë çdo javë në ERE mbi ecurinë e tregut të balancimit të energjisë elektrike.

4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM

4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI

Viti 2021 u karakterizua në tërësinë e tij nga një situatë e favorshme hidrike si pasojë e reshjeve më intensive dhe prurjet më të mëdha në historinë e operimit të kaskadës. Në total, prurjet mesatare në Fierzë gjatë vitit 2021 ishin 233 m³/s ose 29.8% më shumë se mesatarja 15 vjeçare (2006-2020) prej 179 m³/s. Në Janar 2021 u regjistrua edhe piku i prurjeve rekord prej 4,670 m³/s, më e larta e regjistruar ndonjëherë. Ndërkohë, shkarkimet e regjistruara nga portat e HEC të Vaut të Dejës nuk e kaluan asnjëherë vlerën 900 m³/s, më të ulëta deri më sot, duke rezultuar 54% më pak se në 2018 dhe 58% më pak se në 2010, si periudha të ngjashme në situatë me 2021. Kjo situatë u mirë administrua duke monitoruar dhe rikonsideruar kapacitetet rezervuese në të tre basenet e kaskadës ditë pas dite dhe në sinkron me parashikimet hidrometeorologjike, duke evituar plotësisht situatë përmbajtje në zonën e ultësirës Shkodër-Lezhë. Rrjedhimisht, efektet e faktorëve kryesore si reshjet intensive dhe prurjet e shumta në Fierzë u reflektuan në prodhimin total bruto të kaskadës prej 5,393 GWh ose 26% më të lartë se mesatarja 15 vjeçare (2006-2020) prej 4,281 GWh.


Tabela 2. Prurjet dhe prodhimi 2021 vs Mesatarja Shumëvjeçare

Prurjet dhe Prodhimi	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Mesatarja 15 vjeçare
Prurjet në Fierzë (m ³ /sek)	233	119	121	235	131	228	179
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	129.8%	66.3%	67.4%	130.9%	73.0%	127.0%	
Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)	5,393	3,121	3,009.8	5,902	2,945	5,151.8	4,281
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	126.0%	72.9%	70.3%	137.9%	68.8%	120.3%	

Shënim: Mes. 15 vjeçare i referohet viteve 2006-2020.


Siç u përmend më parë, fillimi i vitit 2021 u karakterizua nga reshje të shumta të cilat bënë që prurjet mesatare të muajve të parë të ishin më të mëdha në krahasim me mesataren shumëvjeçare, ku në veçanti muajt Janar dhe Shkurt kishin respektivisht 240% dhe 122% më shumë prurje se mesatarja shumëvjeçare (2006-2020). Kurse për 6 mujorin e dytë (Korrik-Dhjetor) të vitit 2021, prurjet mesatare rezultuan afërsisht në 105 m³/s ose rreth 9% më të ulëta se mesatarja shumëvjeçare për të njëjtën periudhë me 115 m³/s.

Grafiku 4. Prurjet dhe Prodhimi 2021 vs Mesatarja Shumëvjeçare




Për sa i përket nivelit të shfrytëzimit, niveli në fund të Qershorit rezultoi 291.69 m.mnd ose rreth 1.9 m më i lartë se mesatarja shumëvjeçare (1990-2020), ndërsa në fund të muajit Dhjetor niveli ishte rreth 275.13 m.mnd ose rreth 2.7 m më i ulët se niveli mesatar me rreth 277.83 m.mnd. Niveli optimal i rezervës energetike i parashikuar për vitin 2021 garantoj përbushjen në vijimësi të detyrimeve të KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së konsumatorëve fundorë.

Grafiku 5. Prurjet në Fierzë dhe Niveli Mesatar i Shfrytëzimit për 2021



Referuar të mëposhtëm, shihet qartë se kushtet e favorshme meteorologjike në 6 mujorin e parë ndikuan pozitivisht si në Rezervën Energetike ashtu edhe në Prodhimin Mesatar Mujor, ku në muajt Janar-Qershor Rezerva Energetike ishte rreth 40% më e lartë se mesatarja shumëvjeçare (1990-2020). Ndërkohë Prodhimi Mesatar Mujor ishte 54% më i madh se mesatarja shumëvjeçare (1990-2020).

Grafiku 6. Prodhimi dhe Rezerva Energetike gjatë vitit 2021



Referuar tabelës së mëposhtme, vërejmë një ngarkesë mesatare të agregateve lehtësisht më e lartë krahasuar me vlerat shumëvjeçare dhe konsumi i ujit/kWh të prodhuar mbetet në tërësi po i njëjti. Gjithashtu niveli mesatar i shfrytëzimit në Fierzë ishte 283,88 m, ose 1.84 m më i lartë se mesatarja shumëvjeçare prej 282.04 m, ndërsa në HEC Koman dhe Vau i Dejës ky tregues mbetet thuajse i njëjtë me mesataren shumëvjeçare. Kjo justifikon më së miri programimin eficient të regjimit operacional të kaskadës në një vit të mirë hidrik si 2021, ku liqeni i HEC Fierzë ka rolin parësor të rregullatorit dhe depozituesit të rezervës energjetike, ndërkohë dy HEC e tjerë dhe sidomos Komani si HEC me fuqinë më të madhe të instaluar, kanë rolin parësor të prodhimit të energjisë.

Tabela 3. Efienca në Gjenerim gjatë vitit 2021 krahasuar me mesataren shumëvjeçare

Efienca në Gjenerim		Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Mesatarja 15 vjeçare
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	3.98	4.09	4.04	3.79	4.16	3.61	3.89
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	283.88	279.40	277.03	285.75	274.83	290.54	282.04
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	86%	85%	84%	87.0%	86.1%	90.2%	80%
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.19	4.19	4.23	4.17	4.14	4.14	4.19
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.33	172.38	171.65458	172.82	172.95	173.27	172.25
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	79%	76%	76%	71.9%	65.0%	62.8%	70%
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.49	8.28	8.45	8.48	8.52	8.45	8.45
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.90	73.81	74.04	74.30	73.91	74.32	74.11
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	77%	78%	84.9%	83.4%	78.9%	80.8%	80%

Shënim: Mes. 15 vjeçare i referohet viteve 2006-2020

Tabela 4. Krahasimi i prodhimit dhe efijencës në vite të ngjashme meteorologjike

Efienca në Gjenerim		2021	2018	2013	2010
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	3.98	3.79	3.73	3.58
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	283.88	285.75	286.38	290.20
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,803	2,209	2,022	2,664
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.19	4.17	4.20	4.19
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.33	172.82	172.89	171.93
	Energji e Prodhuar (GWh)	2,440	2,447	2,470	2,873
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.49	8.48	8.44	8.47
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.90	74.30	74.25	74.06
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,149	1,246	1,312	1,510
Prodhimi i Kaskadës (GWh)		5,393	5,902	5,805	7,047

Tabela e mësipërme pasqyron krahasimin e efijencës dhe prodhimit në vite të ngjashme meteorologjike, në të cilin shikohet efienca e shtuar e prodhimit të kaskadës në raport me konsumin e ujit për njësi të prodhuar. Marrë në tërësi për të 3 HEC-et, ky konsum është pak më i lartë në vlerë absolute me mesataren e konsumit të viteve të ngjashme meteorologjike.

Referuar tabelës së mëposhtme, falë situatës së favorshme hidrike gjatë muajve të parë të vitit 2021, ku prurjet mesatare natyrale në Kaskadën e Drinit ishin 384 m³/sek (29.3% më të larta se mesatarja 15 vjeçare prej 297 m³/sek), u arrit të prodhohej një sasi e kënaqshme prej 5,393 GWh, dhe njëkohësisht të ruhet rezerva energjetike optimale në vlerën mesatare prej 937.11 GWh (6.6% më e lartë se mesatarja 15 vjeçare e rezervës energjetike). Po kështu, veçojmë ruajtjen e nivelit të Fierzës në kuota optimale, i cili në fillim të muajit Korrik 2021, rezultoi në vlerën 291.69 m (rreth 1 m më lart se niveli mesatar 15 vjeçar referues prej afërsisht 290.54 m) ose edhe në fillim të Dhjetorit rezultoi në kuotën 267.77 m (7.5 m më ulët se niveli mesatar 15 vjeçar referues prej 275.26 m).

Tabela 5. Shfrytëzimi dhe Menaxhimi i Prurjeve Natyrale në Kaskadën e lumit Drin
(Analizë krahasuese për vite me situatë të ngjashme hidrike)

Treguesit për vitet	2021	2018	2013	2010	Mesatarja 15 vjeçare	2021 vs Mesatarja 15 vjeçare
Niveli në Fillim Janar (mmnd)	272.20	289.81	276.49	293.09	278.48	-2.2%
Niveli në Fillim Korrik (mmnd)	291.69	296.10	294.08	293.03	290.54	0.4%
Niveli në Fillim Dhjetor (mmnd)	267.77	267.89	282.46	290.08	275.26	-2.6%
Rezerva Mesatare Energjitike (GWh)	937.11	1020.56	1008.65	1140.70	879.0	6.6%
Prodhimi (GWh)	5,393	5,902	5,805	7,047	4,278.0	26%
Prurjet Mesatare Natyrale në Drin (m³/sek.)	384	378	410	582	297	29.3%
Shkarkimet nga Tunelet Fierzë (million m³)	453	473.2	141	1,957.1	301	50.5%
Shkarkimet nga Tunelet Koman (million m³)	503	1,467.6	1,454	4,493.1	696	-27.8%
Shkarkimet nga Porta Vau Dejës (million m³)	1,755	2,170.4	1,389	5,528.7	914	91.9%
Shkarkimet totale (million m³)	2,711.2	4,111.2	2,983.9	11,978.9	1,911.9	41.8%
Kapacitetet Gjeneruese në dispozicion (MW)	1,171.18	1,202	1,295	1,321	1,219	-4%

Shënim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2006-2020

Të gjithë treguesit e mësipërm tregojnë për një programim operimi racional/efiçent dhe nën monitorim të kujdesshëm për të mbajtur në ekuilibër optimal variablat Prurje-Nivel-Prodhim-Rezervë Energjetike.

4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE

Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Rregullorja e Përgjithshme e Punës në KESH sh.a., Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, VKM-së Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, KESH sh.a., gjatë viti 2021 ka realizuar në mënyrë sistematike monitorimin e gjendjes teknike dhe sigurisë së 6 (gjashtë) digave të kaskadës së lumit Drin në të tre HEC-et e kësaj kaskade që janë nën administrimin e KESH sh.a.

Bazuar në kërkesat e mësipërme lidhur me sigurinë e veprave hidroteknike, janë realizuar monitorimet dhe matje në objektet përkatëse të digave, sistemeve të shkarkimit, veprave të marrjes së ujit si dhe tek masivët rrëshqitës. Në bazë të rezultateve të matjeve dhe vrojtimit të mësipërme është realizuar përpunimi i të dhënave si dhe analiza, interpretimi dhe raportimi i tyre në mënyrë periodike (çdo muaj), si dhe pasqyruar në Raportin Vjetor të Shfrytëzimit, Monitorimit dhe Sigurisë së Digave.

Për kontrollin dhe monitorimin e digave, informacioni i përpunuar është përfutur nga sistemet e monitorimit të instaluar në kaskadë, sikurse janë:

1. Sistemi i Monitorimit Gjeologjik

Gjatë vitit 2021 është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit gjeologjik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

2. Sistemi i Monitorimit Gjeodezik

Për monitorimin gjeodezik të digave të kaskadës kryhet monitorimi i rrjetit gjeodezik i përbërë nga reperë gjeodezik, monumentet gjeodezikë, pika e referimi, pika nivelacioni.

3. Sistemi i Monitorimit Hidrologjik

Matjet kryhen në mënyrë automatike dhe transmetimi i të dhënave kryhet në kohë reale. Sektori që kryen këtë monitorim përgjatë vitit 2021 ka qenë pjesë integrale e DPGjO por që ka vazhduar të mbajë me informacion edhe DSD.

4. Sistemi i Monitorimit Sizmik

Transmetimi i të dhënave kryhet online nga HEC-et në Drejtorinë e Sigurisë së Digave dhe për eventet në raste tërmetesh njoftimet vijnë në kohë reale në DSD. Gjatë vitit 2021 është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit sizmik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

5. Sistemi i Monitorimit të Filtrimeve

Rezultatet e monitorimeve hidro-teknike kanë përcaktuar edhe aktivitetet prioritare për mirëmbajtjen dhe/ose rehabilitimin e tyre. Punimet civile për mirëmbajtjen e veprave hidroteknike konsistojnë jo vetëm në punime të zakonshme të mirëmbajtjeve dhe riparimeve, por edhe në investime themelore.

4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE

Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Mirëmbajtjes është përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit teknik të mirëmbajtjes elektromekanike të aggregateve dhe pajisjeve në tre hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin, duke harmonizuar mirëmbajtjen e planifikuar periodike me mirëmbajtjen e bazuar në kushtet e pajisjeve (Condition based maintenance) nga sistemet on-line të monitorimit, mbështetur me investime elektromekanike për upgrade/rinovime të plota teknologjike të sistemeve ekzistuese.

Objekti kryesor i Mirëmbajtjes gjatë vitit 2021 është mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve gjeneruese, nëpërmjet diagnostikimit në kohë shoqëruar me shërbime efektive mirëmbajtjeje të aggregateve, investime efektive në pajisjet dhe sistemet elektro-mekanike të rëndësishme të aggregateve, duke parandaluar avaritë e defektet apo minimizuar numrin e tyre, si dhe mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme e pajisjeve të veprave të shkarkimit të plotave.

Grafiku 7. Treguesit e Mirëmbajtjes së Sistemeve Hidroenergjetike 2016-2021



Ndër investimet e natyrës mirëmbajtëse/ekzistuese apo rinovuese/investuese, më kryesoret përmendim:

1. Zbatimi i projektit të kontratës së rehabilitimit me rinovim teknologjik të kushinetave mbështetëse HEC Vau i Dejës ku gjatë 2021 u përfunduan punimet në AG4 dhe AG2;

2. Zëvendësimi i Transformatorit 170 MVA ne bllokun e dyte te njësive prodhuese ne HEC Koman,
3. Zëvendësimi i releve te mbrojtjes së bllokut Gjenerator-Transformator për dy agregate ne HEC Vau Dejës,
4. Riparime emergjente në rrotën e punës së turbinës së agregatit Nr. 1 dhe agregatit Nr. 3 në HEC Fierzë, dhe agregatit Nr. 2 dhe Nr. 5 në HEC Vau Dejës, Instalimi i video-wallit ne sallën e Komandës në HEC Koman dhe transmetimi i sinjaleve të sistemit SCADA në qendrën dispeçer në Tiranë.

Në Hidrocentralet e Kaskadës së Drinit zbatohen planet e integruara dhe të koordinuara të remonteve kapitale, remonteve të mesme dhe ato profilaktike të njësive prodhuese, të pajisjeve të veprave të shkarkimit si dhe të pajisjeve ndihmëse.

Për 2021 treguesit e mirëmbajtjes vijojnë të përmirësohen krahasuar me vitet e mëparshme si dhe me mesataren e 10 (dhjetë) viteve të fundit. Performanca e mirëmbajtjes është përmirësuar si rrjedhojë e gatishmërisë së lartë të njësive për operim, efikasitetit të kontrolleve të vazhdueshme parandaluese, shërbimeve cilësore të mirëmbajtjes gjatë remonteve profilaktike e të mesme, si dhe investimeve për rinovime teknologjike të tyre e pajisjeve të tjera në tre HEC-et e kaskadës së Drinit.

Nder treguesit e performancës për vitin 2020 krahasuar me 10 vjeçarin mund të përmendim:

1. Orët e ndërprerjeve për shkak të anomalive kalimtare kanë qenë 66.8, ose 58.6% e mesatares 10 vjeçare.
2. Numri i avarive/defekteve ka qenë 33, ose 58.9% e mesatares 10 vjeçare.
3. Koeficienti i gatishmërisë së agregateve është në vlerën 99.9% ose 0.12% me lart se mesatarja 10 vjeçare.

Për të gjitha rastet e avarive në njësitë e prodhimit të tre HEC-ve të kaskadës së Drinit, asnjëherë ndalimi i tyre nuk ka rezultuar me kohëzgjatje që imponojnë remonte të parakohshme për riparime kapitale. Është e rëndësishme të theksohet që rritja e gatishmërisë ndikon direkt edhe në shkallën e efijencës dhe cilësinë e prodhimit.

4.4 CILËSIA E PRODHIMIT

Hidrocentralet e kaskadës mbi lumin Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) kanë në funksion sistemet e rregullimit automatik të frekuencës dhe të tensionit që garantojnë cilësinë e energjisë elektrike të prodhuar duke përmbyshur në këtë mënyrë kërkesat e kodit të rrjetit.

KESH sh.a., ka përmbyshur kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit dhe kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, dhe tashme në të gjitha njësitet gjeneruese të secilës njësi prodhimi kemi të instaluar:

1. Sistemet statike dixhitale të rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve (AVR).
2. Sistemet dixhitale të rregullimit automatik të shpejtësisë së turbinave.

Të gjithë sistemet e sipërpërmendura operohen dhe mirëmbahen nga DM dhe sektorët e mirëmbajtjes në të tre njësitet gjeneruese të Korporatës duke siguruar në këtë mënyrë:

- a. cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin e tensionit/fuqisë reaktive në dalje të njësive gjeneruese.
- b. cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin primar dhe sekondar të frekuencës/fuqisë aktive në dalje të njësive gjeneruese.
- c. rritje të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar si rrjedhojë e amplifikimit të lartë dhe të stabilizimit të lëkundjeve të sistemit nga sistemet e rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve me AVR dhe PSS.
- d. siguri dhe gatishmëri e lartë në operimin e njësive gjeneruese.
- e. rritje të sigurisë dhe besueshmërisë së prodhimit të energjisë/furnizimit të vendit.
- f. të ardhura më të larta për shoqërinë nga shitjet e energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse.

- Projekti për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzës:

Në bazë të ligjit Nr. 69/2021 datë 20.5.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2019 për projektin “Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës”. Njëpërmjet kësaj marrëveshjeje u siguroi një kredi e butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW e cila do të shkojë për rehabilitimin e plotë elektro-mekanik të HEC Fierza. Pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje ka nisur puna nga KESH dhe KfW për fillimin e zbatimit të këtij projekti.

Në vijim të kësaj, në datë 28.01.2022 u nënshkrua marrëveshja për financimin e këtij projekti. Ky financim konsiston në dhënie të një kredie të butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW si dhe një grant prej EUR 8.35 Mln. nga BE njëpërmjet WBIF. Pas firmosjes së kësaj marrëveshjeje ka nisur puna nga KESH dhe KfW për fillimin e zbatimit të këtij projekti.

Ky projekt madhor ka rëndësi shumë të madhe si për mirëmbajtjen ashtu si dhe për sigurinë dhe cilësinë e prodhimit, pasi lidhet me rehabilitimin E-M të hidrocentralit të sipërm të kaskadës dhe rregullator të gjithë kaskadës së Drinit, me një impakt thelbësor në menaxhimin operacional të prodhimit.

5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2021

Duke qenë 2021, klasifikohet nga një vit hidrik pozitiv (sidomos pjesa I e vitit), bëri të mundur gjenerim të kënaqshëm të volumeve fizike të energjisë duke krijuar mundësi aktiviteti të shtuar si në tregun e rregulluar ashtu edhe atë të parregulluar (të lirë).

5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK

Volumet fizike të prodhimit, tregtimit dhe shkëmbimit, jo vetëm që tejkaluan pritshmëritë e PEF të miratuar fillestar, por ato edhe më të larta se PEF të Rishikuar II. Më poshtë pasqyrohet Bilanci Energjetik i realizuar 2021 dhe krahasimi me PEF të Rishikuar II 2021:

Tabela 6. Bilanci Energjetik për vitin 2021 (MWh)

Treguesit	Viti 2021 (PEF i rishikuar II)	Viti 2021 (Fakt)	Viti 2021 (Fakt-PEF) (Sasi)	Viti 2021 (Fakt-PEF) (%)
Sasia kontraktuale sipas shifrës së vendosur nga MIE me Vendim Nr.135/1, datë 14/01/2021 (PEF KESH sh.a. 2021-2025)	3,950,000	4,144,704	194,704	4.93%
Prodhimi neto KESH	5,320,988	5,343,974	22,986	0.43%
Shkëmbimi KESH / marrje	130,162	130,162	0	0.00%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas)	0	0	0	0.00%
Blerje energjie për optimizim	13,922	54,194	40,272	289.27%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	203,204	235,797	32,593	16.04%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	6,727	3,872	-2,855	-42.44%
Blerjeje, Ashta energji balancuese neto	2,634	3,243		
Disbalanca negative KESH	15,385	18,286	2,901	18.85%
Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5,693,022	5,789,528	96,506	1.70%
Shitje OSHEE klientë tariforë	4,124,538	4,144,704	20,166	0.49%
Shitje OSHEE humbje	0	0	0	0.00%
Shitje OST humbje	117,051	130,151	13,100	11.19%
Shitje KOSTT per humbjet	3,127	3,127	0	0.00%
Shkëmbimi KESH / dhënie	150,177	156,477	6,300	4.20%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	1,107,647	1,125,827	18,180	1.64%
Shitje energjie për optimizim	17,902	18,142	240	1.34%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	118,677	132,138	13,461	11.34%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	27,459	43,201	15,742	57.33%
Shitje, Ashta energji balancuese neto	855	3,226	2,371	277.30%
Disbalanca pozitive KESH	25,589	32,536	6,946	27.15%
Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim	5,693,022	5,789,528	96,506	1.70%
Disbalanca energjie për t'u verifikuar nga Operatori i Tregut	0.0	0.0	0.0	0%


Në total, volumi i energjisë elektrike për tregtim nga KESH sh.a. ka rezultuar në sasinë prej 5,789,528 MWh (+96,506 MWh ose 1.7% më shumë se PEF i rishikuar).

Grafiku 8. Energjia elektrike disponibël për shitje/tregtim për vitin 2021 (MWh)




Volumet dalëse të energjisë elektrike për vitin 2021, grafiksht paraqiten si më poshtë:

Grafiku 9. Energjia elektrike e shitur/tregtuar për vitin 2021 (MWh)



Krahasuar me vitin 2020, realizimet e zërave kryesorë të Bilancit Energjetik 2021 paraqiten si më poshtë:

Grafiku 10. Shitje Energjie – Realizim 2021 vs Realizim 2020 (MWh)




Ashtu si pasqyrohet në grafik, volumet fizike të energjisë së shitur gjatë 2021 janë qartësisht më të larta krahasuar me 2020, duke treguar një performancë mjaft pozitive të Korporatës në aspektin tregtar.

5.2 AKTIVITETI NË TREGUN E RREGULLUAR


KESH sh.a. për periudhën Janar-Korrik 2021 ka bërë furnizim të plotë me energji elektrike të kërkesës së shoqërisë FSHU, kjo nisur edhe nga kushtet meteorologjike me rreshje shiu për periudhën Janar-Maj 2021. Gjatë 2021, KESH sh.a. ka shitur energji elektrike më shumë se detyrimi kontraktual, konkretisht rreth 194 GWh më shumë, cka në zbatim të VKM 620/2021 e ndryshuar me VKM 757/2021 ku i është vendosur KESH sh.a. detyrimi për shërbim publik, e gjithë sasia do ti faturohet FSHU me çmime të rregulluar. Më poshtë paraqitet furnizimi me energji elektrike nga KESH sh. për 4 vitet e fundit, ku rezulton si më poshtë:

Grafiku 11. Furnizimi – Detyrimi i Shërbimit Publik 2018-2021 (GWh)



Në lidhje me Shërbimet e Balancimit për vitin 2021, ato kanë njohur një aktivitet të shtuar pasi në aktivizimi zbritje është 36% dhe aktivizimi në rritje 49% më i lartë krahasuar me atë të vitit 2020. Kjo sjellje e aktivizimit të rezervës në kuadër të balancimit të sistemit elektroenergjetik Shqiptar, është një tregues i mekanizmit të balancimit, që vjen si rrjedhojë e problematikave që lidhen me dimensionimin e kapaciteteve rezervë nga ana e OST sh.a dhe më tej nga mënyra e operimit të pjesëmarrësve të tregut.

Grafiku 12. Shërbimet ndihmëse/balancimit për vitet 2018-2021



Në terma monetarë, të ardhurat neto të krijuara nga ofrimi i shërbimit të balancimit për 2021 janë shumë më të larta, kjo për faktin pasi KESH sh.a. përlogarit çmimin e energjisë balancuese që oferton me çmimin e tregut të energjisë. Më poshtë pasqyrohet grafiksht dinamika e ecurisë së aktivitetit të netuar të KESH për shërbimet e balancimit me OST gjatë periudhës 2018-2021:

Grafiku 13. Të Ardhurat Neto nga shërbimet e Balancimit 2018-2021



Nga grafiku më lart, qartësisht dallohet përfitueshmëria gjatë 2021 e aktivitetit të shërbimeve të balancimit.

E rëndësishme është të theksohet që ofrimi i shërbimeve të balancimit si produkt në treg të lirë pas dt. 01 Prill 2021, do të zgjidhë edhe Korporatën nga detyrimi për këtë shërbim ndaj balancimit të sistemit, kjo për shkak se edhe gjatë 2021 vërehet fenomeni ku blerjet fizike për këto shërbime janë më të larta se shitjet, duke ndikuar në përfitueshmërinë e Korporatës nga mekanizmi i balancimit.

Duke u trajtuar si volume të tregut të lirë kjo do të nxis pjesëmarrësit të jenë më të motivuar dhe të angazhuar në përmirësimin e parashikimeve të nevojave dhe aktivitetit tregtar të tyre dhe për skedulim më të saktë. Kjo lidhet edhe me faktin se sa likuid është zbatimi i mekanizmit të balancimit dhe dimensionit të kapacitetit rezervë nga ana e OST.


5.3 AKTIVITETI NË TREGUN E LIRË

Viti 2021, ka qenë një periudhë mjaft pozitiv, në lidhje me aktivitetin e Korporatës në tregun e lirë si rrjedhojë e kushteve hidrike pozitive, të cilat bënë të mundur shitjen e volumeve në tregun e lirë, duke rritur ndjeshëm edhe të ardhurat për Korporatën.

Veprimtaria në tregun e lirë gjatë 2021, ka rezultuar me të ardhura neto prej rreth 60.2 Mln. Eur. Edhe grafikisht këto të ardhura janë afërsisht të lagësht 2018 (referuar periudhës 2013-2021).


Grafiku 14. Të Ardhurat Neto në Tregun e Lirë 2013-2021

Transaksionet Energjitike gjatë periudhës 2013-2021



Në lidhje me shitjet për humbjet në transmetim si për OST edhe KOSTI, performanca gjatë vitit 2021 ka qenë mjaft e kënaqshme si në volume prej 134,335 MWh ashtu edhe në vlerë në afërsisht 9.5 Mln. Eur. Më poshtë paraqitet grafikisht ecuria në volume dhe vlerë për periudhën 2018-2021:

Grafiku 15. Ecuria për Shitje Humbje Transmetimi (2018-2021)




Referuar grafikut të mësipërm, të ardhurat nga shitjet humbje transmetimi gjatë vitit 2021, krahasuar me periudhat e mëparshme por veçanërisht me 2020 ka qenë dukshëm më e lartë.

Rritja e të Ardhurave nga Shitjet për Humbje në Transmetim, përveç rritjes në volume, i dedikohet veçanërisht rritjes së çmimit të shitjes të këtij produkti, duke treguar edhe efektivitet të lartë në këto transaksione. Edhe grafikisht evidentohet qartë që çmimi mesatar i shitjes së humbjeve në transmetim gjatë 2021 është rreth 71 Eur/MWh, ndjeshëm më i lartë, krahasuar me periudhën (2018-2020):

Gjatë vitit 2021 është kryer një menaxhim eficient i portofolit energjetik i orientuar nga sinjalet e çmimeve të tregut. Krahasuar me vitet e mëparshme optimizimi tërësor si në sasi ashtu edhe në vlerë ka qenë mjaft domethënës. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen transaksionet në shitje dhe blerje me efekte optimizimi për periudhën 2017-2021.

Grafiku 16. Efekti i Optimizimit të Portofolit për vitet 2017-2021 (EUR)



Grafiku i mësipërm tregon rritjen e dukshme të efektit neto të optimizimit ndërmjet transaksioneve blerje-shitje energjie të kryera gjatë 2021, në kushtet e tregut të lirë, duke treguar edhe aktivitetin dinamik komercial dhe marzh të kënaqshëm përfitimi. KESH e mbylli vitin 2021 me efekt optimizimi neto prej rreth 5.16 Mln. Eur me një diferencë/marzh çmimi mesatar mjaft të kënaqshëm prej 44.82 Eur/MWh.

6. AKTIVITETI INVESTUES

6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2021


Referuar situatës së favorshme hidrike si pjesë përbërëse e rishikimit të PEF për vitin 2021 ka qenë edhe rishikimi i planit të investimeve. Në total, vlera e investimeve të realizuara për 2021 ka rezultuar në 4,419 mln. Lekë. Politika investuese e Korporatës është fokusuar në sigurinë dhe efçencën e veprave hidrike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve pasi asetet gjeneruese aktuale, për vetë madhësinë dhe problematikën e amortizimit të tyre në vite, kanë nevojë për investime mirëmbajtëse/rinovuese dhe modernizuese periodike.

Ndërkohë, fokusi është shtuar edhe tek zhvillimi strategjik nëpërmjet investimeve në kapacitete të reja dhe të diversifikuara të BRE, me projekte konkrete për zbatim në këtë fushë.

Referuar tabelës së mëposhtme, në vitin 2021 vërehet një rritje e realizimit të investimeve në vlerë absolute prej 30% krahasuar me realizimin në 2020.

Në realizimin e investimeve, Aparati Qendror përbën 41% të realizimit, ndjekur nga HEC Koman me 22%, HEC Vau i Dejës me 19% dhe HEC Fierza me 18%.

Grafiku 17. Realizmi i Investimeve për vitet 2015-2021
Investimet e Realizuara sipas Burimit të Financimit



Referuar grafikut të mësipërm, realizimi i investimeve për 2021 sipas burimit të financimit, ndahet në 76% me fondet e vetë Korporatës dhe 24% me fondet e Huaja.

Në lidhje me qëllimin e realizimit të investimeve në 3 drejtimit kryesore të cilat janë: garantimi i sigurisë së veprave, rritja e efijencës në prodhim dhe përmirësimi i kushteve të punës, më poshtë shfaqet grafiku në vijim:

Grafiku 18. Realizmi i Investimeve për vitet 2015-2021
Investimet sipas Qëllimit të Realizimit



Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, volumi më i madh i fondit të investimeve është alokuar për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave hidrike. Këto investime kanë rëndësi të veçantë pasi përveçse parandalojnë riskun që shoqëron veprimtarinë e natyrës apo të shoqërisë por sigurojnë dhe kontribut për mjedisin dhe komunitetin e zonave përreth veprave, duke përbushur në këtë mënyrë edhe përgjegjësitë social mjedisore. Konkretisht siguria e veprave përbën 54% të realizimit të investimeve, e ndjekur nga rritja e efijencës së prodhimit me 42% dhe përmirësimi i kushteve të punës me 4%.

6.2 INVESTIMET E FINANCUARA NGA PARTNERËT NDËRKOMBËTAR

Investimet në Sigurinë e Digave financohen paralelisht nga disa institucione ndërkombëtare financiare si Banka Botërore (WB), Sekretariati Shtetëror i Bashkëpunimit Financiar Zviceran (SECO), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Banka Botërore ka rolin e udhëheqësit ndër këto institucione të cituara më lart.

1. Banka Botërore (WB) – SDR 21.7 Milion

Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC-eve Fierzë dhe Koman

Rehabilitimi i portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit në HEC Koman dhe Fierze përfundoi me sukses duke realizuar objektivin 100% në muajin Nëntor 2021.

Disbursimet e pagesave janë në proces sipas procedurave të Bankës Botërore deri në muajin Prill 2022.

2. SECO – CHF 6.4 Milion

Projekti i Sigurisë së Digave në Kaskadat e lumenjve Drin

I nënshkruar më 24 Maj 2011, projekti fillestar u përfundua me sukses me investimet në:

- Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeologjik dhe Sizmik të Digave të Kaskadave Drin.
- Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeodetik të Digave të Kaskadave Mat dhe Drin.
- Mbrojtja nga Rreziku i rënies së shkëmbinjve në HEC Fierze.

Marrëveshja e Projektit pas amendimeve të kryera është e vlefshme deri në fund të vitit 2022. Aktualisht SECO po suporton Departamentin e Sigurisë së Digave me ekspertizë në argumentimin e të dhënave monitoruese të digave në kaskadën e Drinit.

3. BERZH (EBRD) – EUR 12.7 Milion

Rehabilitimi i portave të shkarkimit të HEC Koman

Marrëveshja e Financimit me BERZH në shumën e EUR 12.7 milion është bërë efektive më 15 Nëntor 2013. Kjo marrëveshje financoi rehabilitimin e Digës së Komanit e cila përfundoi me sukses në Korrik 2016. Financimi prej EUR 6.128 milion i kursyer nga kjo marrëveshje u transferua si bashkëfinancim me Bankën Botërore për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Koman dhe Fierzë. Ky transferim është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligj të posaçëm. Afati i fundit të disbursimeve për këtë marrëveshje është deri në 31 Dhjetor 2021.

Kontrata ka përfunduar me sukses duke disbursuar shumën e financimit 100%.

4. KfW – EUR 20 Milion

Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC Van i Dejës dhe Implementimi i Qendrës së Kontroll-Monitorimit të Kaskadës së lumit Drin

6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA

1. Gjatë vitit 2021, ndër investimet më kryesore të KESH sh.a. në funksion të sigurisë së veprave hidroteknike përmendim, të përfunduara apo drejt përfundimit:
 - Mbrojtja e shpatit të djathtë të digës HEC Koman;
 - Rehabilitimi i tuneleve dhe galerive ndihmëse të digës HEC Fierzë;
 - Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse të galerisë së kuotës 178 mmnd në Fierzë;
 - Rehabilitimi i tuneleve dhe galerive ndihmëse të digës Koman;
 - Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman;
 - Rehabilitimi i rrugës së aksesit për tek kullat e ekuilibrit;
 - Rikonstruksioni i sallës së makinerive, sallës së turbinave dhe galerive në godinën e centralit të HEC-it (Koman);

- Mbilartësimi, ndërtim/instalim i pritave malore tek përrrenjtë e Salcës dhe Bugjonit;
- Mbilartësimi i pritave malore të përrrenjve Gropaj, Nik Gjeçi, Mark Andreu (pjesa e sipërme e rrjedhës së tyre mbi rrugën nacionale);
- Plotësimi dhe zgjerimi i sistemit të monitorimit hidrometeorologjik në kaskadën e lumit Drin (faza e dytë dhe e tretë);

Realizimi i investimeve në drejtim të mirëmbajtjes së veprave hidroteknike ka qenë i konsiderueshëm dhe me efektivitet në përmirësimin e monitorimit veprave hidroteknike dhe rritjen e sigurisë së tyre.

2. Ndërsa me fondet e vetë Korporatës janë kryer investime elektro-mekanike të karakterit riparues/rinovues si:

- Projekti “Rehabilitimi me Rinovim Teknologjik të Kushinetave Mbështetëse të 5 agregateve të HEC Vau Dejës”
Investimi i rehabilitimit me rinovim teknologjik të kushinetave mbështetëse është zbatuar tek Ag4 dhe AG2. Rehabilitimi i AG4 ka përfunduar në Tetor 2021, ndërsa rehabilitimi i AG2 ka përfunduar në Dhjetor 2021. Të dy agregatat janë dorëzuar për operim normal për periudhën e garancisë 2 vjeçare;
- Projekti “Riparimi i dëmtimeve të turbinave të Agregatit Nr.1 dhe Nr.3 në HEC Fierzë dhe rehabilitimi i dëmtimeve të turbinave të 5(pesë) agregatëve në HEC Vau Dejës”;
- Projekti “Blerje dhe instalimi i një transformatori fuqie 170 MVA, 242/13.8 kV për HEC Koman, përfshirë pjesët rezervë, ri-instalimin dhe komisionimin e sistemit ekzistues të mbrojtjes kundër zjarrit të transformatorit si dhe sistemit ekzistues të monitorimit DGA&BMT të transformatorit”;
- Rinovimi i sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë në HEC Vau Dejës;
- Projekti “Furnizim, instalim, konfigurim Video-Wall në sallën e komandës së HEC Koman, konfigurimi dhe aktivizimi i listës së sinjaleve të sistemit DCS Koman për transmetim në qendrën e monitorimit të dispeçerisë KESH sh.a.”;
- Ekskavator special dhe grejfer hidraulik në HEC Koman;
- Projekti “Furnizimi dhe instalimi me bateri stacionare akumulatorë, acide elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V në ndërtesën e centralit dhe për një sallë 220VDC në N/Stacionin 220kV, me aksesoret përkatës të montimit dhe instalimit për HEC Fierzë”.

3. Në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit janë kryer investime si:

- Shërbime për enkriptimin e komunikimit midis njësive qendër dhe HEC-eve;
- Përgatitja e një projekti teknologjik të një sistemi për parashikimin satelitor meteorologjik së bashku me algoritmin e parashikimit të prurjeve nga shirat dhe shkrirja e borës;
- Përmirësime në sistemet e automatizimit si gjeomonitorimi dhe sistemi i sigurisë së digave;
- Mirembajtja 3-vjeçare e sistemit ekzistues hidrometeorologjik, zëvendësimi i pjeseve të demtuara me të reja, komisionimi dhe kolaudimi i tyre në vend;
- Fillimi i implementimit për ngritjen e qendrës së monitorimit dhe kontrollit të HEC-eve për integrimin e të gjithë sistemeve të automatizimit të linjave të prodhimit në sallën e dispeçerisë në zyrat qendrore të KESH;
- Vazhdimi i implementimit i sistemit ERP të Menaxhimit;
- Përmbledhja e të gjithë nevojave dhe kërkesave për aplikimin e standardeve të sigurisë së informacionit ISO 27001.

Objektivat për vitin 2022 është certifikimi ISO 27001 do të ndihmojë DATIK dhe KESH të ketë procedura dhe rregullore të qarta dhe funksionale për të siguruar të gjithë aktivitetin teknologjik dhe evidentuar çdo rrezikshmëri kibernetike si faktor kyç për infrastrukturën kritike, si dhe ngritja e qendrës së monitorimit dhe kontrollit të HEC-eve.

6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE DHE PËRGJEGJSHMËRIA SOCIAL-MJEDISORE

Si objektiv i rëndësishëm i zhvillimit strategjik të Korporatës është edhe rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga Korporata është në linjë me politikat e vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe bazuar në dokumentin “Zhvillimi i Strategjik i Sektorit Energjetik”, përgatitur nga CMA dhe Growth Lab të Universitetit të Harvardit. Ky dokument përfaqëson një udhërrëfyes, i cili shpalos rrugët konkrete për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të integruar të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar, ku KESH sh.a. si një aktor qendror i sektorit ka rol kryesor. Në këtë kuadër zhvillimor, gjatë vitit 2021 është për tu evidentuar avancimi i projekteve të Korporatës për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë:

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik lundrues 12.9 MWp në liqenin e Vaut të Dejës:

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e cila ka shprehur gatishmërinë për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Gjatë këtij viti u nënshkrua marrëveshja e kredisë ndërmjet KESH sh.a. dhe BERZH, si dhe gjithashtu ka filluar puna për realizimin e këtij projekti. Në vijim, ka përfunduar dokumentacioni i tenderit për supervizionin dhe janë duke u përgatitur dokumentet e tenderit për përzgjedhjen e subjektit që do të ndërtojë këtë impiant. Po kështu projekti është pjesë e aplikimeve për grant në kuadër të programit financues të WBIF-EIP që pritet të miratohet gjatë 2022.

- Impianti fotovoltaiik 5.14 MWp në digën e Qyrasqit të HEC Vau i Dejës:

Me vendimin Nr. 1868/1 datë 16.02.2021, MIE dha miratimin paraprak për zhvillimin e projektit të instalimit të impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrasqit në hidrocentralin e Vaut të Dejës. Në vijim të këtij miratimi, gjatë këtij viti është përzgjedhur supervizori dhe kontraktori, i cili ka përfunduar dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me studimet dhe projektin e zbatimit, si dhe janë siguruar shumica e lejeve të nevojshme nga institucionet relevante. Në datë 29.10.2021 filluan punimet për zbatimin e projektit. Zbatimi i tij është zhvilluar normalisht dhe brenda 3- muorit I 2022 parashikohet vendosja në funksionim e këtij impianti, i cili do të përbëjë realisht burimin e parë gjenerues funksional të diversifikuar të Korporatës.

- Impianti fotovoltaiik 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC Vau i Dejës:

Ky është një projekt i cili është ende fazën e konceptimit. Objektivat dhe rëndësia e këtij projekti janë të njëjta me projektin e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrasqit. Gjatë vitit 2021, KESH sh.a. ka analizuar mundësinë për instalimin e një impianti fotovoltaiik me fuqi të instaluar deri në 8.25 MWp në digën e Zadejës në HEC Vau i Dejës. Nga analiza paraprake e koncept-idesë rezultoi se ky impiant ka tregues shumë të mirë të efektivitetit energjetik dhe ekonomik. Në vijim KESH sh.a. do të përfundojë një analizë më të thelluar dhe me qëllim zhvillimin e këtij projekti gjatë vitit 2022, sipas stadeve përkatës, ndihmuar edhe nga përvoja e krijuar në implementimin e projektit të digës së Qyrasqit.

- Përgjegjshmëria Social-Mjedisore

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe si prodhues i energjisë elektrike 100% në formën hidro (nëpërmjet HEC), një rëndësi të veçantë për Korporatën ka angazhimi dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të profilizuara në zhvillimin e qëndrueshëm harmonik. Në këtë kuadër KESH është anëtar i IHA (International Hydropower Association), ku aderohet 100 kompani ndërkombëtare që operojnë në 120 vende të botës. Gjatë 2021, IHA ka realizuar disa programe trajnimi për stafin e KESH në kuadër të “Capacity Building”. Tashmë KESH po formëson një personel të brendshëm të kualifikuar dhe të certifikuar nga IHA, të gatshëm për aplikimin e metodave dhe standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm të HEC-ve. Po kështu, në 2021 KESH mori pjesë në Kongresin Botëror të Hidroenergjisë (World Hydropower Congress) ku u publikua dhe Deklarata e San Jose për Hidroenergjinë e Qëndrueshme, e shpallur në përfundim të Kongresit Botëror të Hidroenergjisë, e cila përshkruan vizionin për kontributin e hidrocentraleve në përmbushjen e objektivave globale të klimës dhe zhvillimit. KESH mbështeti publikisht këtë deklaratë duke iu bashkuar listës së gjatë të vendeve nga e gjithë bota që mbështesin arritjen e objektivave global të klimës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Për më tepër, për KESH dhe qeverinë shqiptare do të ishte një vlerë e shtuar mbështetja e IHA ndaj Korporatës në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit për ndërtimin e HEC Skavica, mbështetje të cilën IHA e përkrah vazhdimisht dhe pa rezerva.

7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2021

Volumet e shturara të prodhimit gjatë 2021, i dhanë mundësi Korporatës të ketë një aktivitet tregtar pozitiv, të cilat mundësuan një aktivitet dhe rezultatate pozitiv operacional ekonomik-financiar.

Më poshtë jepen indikatorët kryesorë të aktivitetit ekonomik për vitin 2021 dhe krahasimi i tyre me mesataren 5 vjeçare 2016-2020.

Duhet theksuar që të dhënat ekonomik-financiare të paraqitura në këtë kapitull janë të stadit operacional dhe për rrjedhojë të paçertifikuara ende nga audituesit.

Tabela 7. Treguesit kryesorë të veprimtarisë ekonomike 2016-2021

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Mesatarja 5-vjeçare (2016-2020)
Energjia Neto e Prodhuar nga KESH sh.a (GWh)	5,345.8	3,090	2,979	5,851	2,915	5,092	3,985
Të Ardhura ('000 Lekë)¹	18,904,679	11,366,643	9,910,229	18,396,176	7,289,888	16,521,118	12,696,811
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën ('000 Lekë)	7,213,037	2,087,198	1,863,170	10,391,871	-52,727	1,159,337	3,089,770
Llogari të Pagueshme ('000 Lekë)	35,691,379	41,852,854	48,136,620	39,782,769	55,988,262	52,345,867	47,621,275
Llogari të Arkëtueshme ('000 Lekë)	57,967,812	62,113,518	57,662,140	64,527,159	57,556,133	56,643,866	59,700,563
Shpenzimet Fikse Operacionale ('000 Lekë)²	2,217,636	2,049,910	1,819,613	1,790,946	1,995,347	1,949,857	1,921,135
Shpenzime Operative ('000 Lekë/GWh)	415	663.36	610.76	306.10	684.49	382.95	529.53

1) Të ardhurat perbejnë shitjet për klientët tariforë të OSHEE, shitje në tregun e parregulluar dhe optimizim. Tek Shërbimet ndihmëse dhe të balancimit, Tek rubrika të ardhura të tjera përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata mbi energjinë elektrike (si kamatvonesa, penaltete etj.).

2) Shpenzimet operative fikse lidhen vetëm me aktivitetin operacional të shoqërisë duke zbritur zhvlerësimin/amortizimin, shpenzime demontimi, blerjet e energjisë, gjyba & penaltete dhe shpenzimet financiare.

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme, treguesit kryesorë vlerësohen shkurtimisht si më poshtë:

- Të ardhurat prej 18.9 miliard Lekë konsistojnë në: 14.5 Mld. Lekë nga shitja e energjisë si në tregun e rregulluar ashtu edhe në atë të parregulluar, 3.87 Mld. Lekë nga ofrimi i shërbimeve ndihmëse energjetike dhe 526.8 milion Lekë nga “Të ardhurat të tjera dhe financiare” (ku përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata mbi energjinë elektrike (si kamatvonesa, penaltete etj.).
- Rezultati financiar neto për periudhën është në vlerën 7.21 Mld. Lekë dhe me një prodhim neto prej 5.345 GWh, duke përfaqësuar një vit mjaft të kënaqshëm krahasuar me periudhën 2016-2020 si dhe me vitet e ngjashme hidrike si 2018 dhe 2016.
- Vlen të theksohet se indikator “Shpenzimet Operative Fikse/GWh të prodhuar” është në vlerën 415 mijë Lekë/GWh të prodhuar ose 27.65% me pak se referenca 5-vjeçare prej 529.53 mijë Lekë/GWh të prodhuar, duke rritur eficiencën operationale të Korporatës.

Përmbledhtazi Pasqyra Operacionale e realizimit të të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2021 krahasuar me me Planin e Rishikuar II, jepen si më poshtë::

Tabela 8. Pasqyra Operacionale e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2021


<i>Pasqyra Operacionale Ardhura-Shpenzime (shumat janë të shprehura në mijë lekë)</i>	Njësia	PEF 2021 (i Rishikuar II)	PL 2021 Realizimi (operacional)	Ndryshimi në Vlerë (PL Realizimi - PEF i Rishikuar II)	Ndryshimi në % (PL Realizimi - PL i Rishikuar II)
Totali i Prodhimit Neto KESH	MWh	5.320.988	5.343.974	22.986	0,43%
<i>Energji e tregtuar për furnizim OSHEE-Klientë Tariforë</i>	"	4.124.538	4.144.704	20.166	0,49%
<i>Energji e tregtuar në tregun e parregulluar (përfshirë dhe shërbimet e balancimit)</i>	"	1.196.450	1.199.271	2.820	0,00%
Të Ardhura gjithsej	(000) lekë	18.267.313	18.904.679	637.366	3,49%
<i>Shitjet e Energjisë për klientët tariforë të OSHEE</i>	"	8.120.772	6.217.056	-1.903.716	-23,44%
<i>Çmimi i shitjes</i>	lekë/kWh	1,5	1,5		
<i>Shitjet e Energjisë për mbulimin e humbjeve të OSHEE</i>	(000) lekë	0	0	0	0,00%
<i>Shitjet e Energjisë për humbjet e Transmetimit OST</i>	"	810.240	1.144.736	334.496	41,28%
<i>Shitjet e Energjisë për humbjet e Transmetimit KOSTT</i>	"	26.562	26.562	0	0,00%
<i>Shitjet e Energjisë me çmime tregu dhe optimizim (eksport dhe tregu vendas)</i>	"	6.538.161	7.023.637	485.476	7,43%
<i>Shitje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	"	101.272	90.301	-10.971	-10,83%
<i>Të Ardhura të Tjera (Shërbime ndihmëse)</i>	"	2.478.097	3.842.409	1.364.312	55,05%
<i>Të ardhura të tjera</i>	"	30.180	33.141	2.961	9,81%
<i>Të ardhura financiare</i>	"	162.028	526.837	364.809	225,15%
Shpenzime gjithsej	(000) lekë	10.337.347	10.418.754	81.407	0,79%
<i>Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu dhe optimizim (import dhe tregu vendas)</i>	"	191.348	217.937	26.589	13,90%
<i>Kompesimi financiar për OSHEE për sasinë e energjisë të munguar</i>	"	1.233.588	1.233.588	0	0,00%
<i>Tarifë Transmetimi</i>	"	5.618	5.499	-119	-2,12%
<i>Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	"	120.391	229.599	109.208	90,71%
<i>Blerje të Tjera (Shërbime ndihmëse)</i>	"	511.792	456.169	-55.623	-10,87%
<i>Shpenzime Personeli</i>	"	1.309.716	1.257.930	-51.786	-3,95%
<i>Materiale të para dhe të konsumueshme</i>	"	154.894	96.639	-58.255	-37,61%
<i>Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi</i>	"	3.618.459	3.561.102	-57.357	-1,59%
<i>Furnitorë dhe Shërbime</i>	"	1.095.337	863.067	-232.270	-21,21%
<i>Shpenzime të tjera</i>	"	1.507.343	1.549.974	42.632	2,83%
<i>Shpenzime financiare</i>	"	588.861	947.248	358.387	60,86%
<i>Shpenzime tatim fitimi</i>	"	1.189.495	1.272.889	83.394	7,01%
Fitimi / (Humbja) neto	"	6.740.471	7.213.037	472.566	7,01%

Bazuar në të dhënat operacionale (rezultati përfundimtar duhet çertifikuar), aktiviteti ekonomik për vitin 2021 rezulton shumë optimal, me një fitim neto prej 7.213 Mld. Lekë, me një përmirësim prej më shumë se 7%, krahasuar edhe me PEF të Rishikuar II 2021.

- Të ardhurat totale janë rritur me gati 3.5% krahasuar me PEF të Rishikuar II, duke tejkaluar edhe parashikimet. Kjo i dedikohet sidomos rritjes së “Të ardhurave nga Humbjet në Transmetim” me 41.28%, “Të ardhurave nga Shërbimet Ndihmëse” me 55.05%; dhe “Shitje për Optimizim” me 7.43%.
- Shpenzimet totale janë pothuajse të njëjta, duke rezultuar me një rritje të lehtë prej 0.79%, krahasuar me PEF të Rishikuar II. Mund të veçojmë rritjen e “Blerjes së Energjisë në tregun e Parregulluar + Optimizim” dhe “Blerje të Energjisë për mbulimin e Disbalancave” me 90.71%. Por e gjitha kjo në kuadër në aktivitetit të shtuar tregtar të energjisë të kryer nga Korporata.

Veçojmë faktin që shpenzimet tjera operationale si “Shpenzime Personeli”, “Materiale të Para dhe të Konsumueshme” apo “Furnitorë dhe Shërbime”, janë më të ulta se PEF i Rishikuar II, duke treguar një qasje mjaft efiçiente në menaxhimin e kostove operative.

Grafiku 19. Pasqyra Operacionale të Ardhura/Shpenzime 2021 ('000 Lekë)



Treguesit agregat të veprimtarisë operationale 2021 krahasuar me 2020, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 20. Të Ardhura/Shpenzime Operacionale 2021 vs 2020



- Të ardhurat Operative nga 11.37 Mld. Lekë në 2020, janë rritur në 18.9 Mld. Lekë në 2021 (+66%);
- Shpenzimet Operative nga 8.91 Mld. Lekë në 2020, janë rritur në 10.42 Mld. Lekë në 2021 (+17%);
- Rezultati para tatimit nga 2.46 Mld. Lekë në 2020, është rritur në 8.48 Mld. Lekë në 2021 (3.45x).

Viti pozitiv 2021, ka ndikuar edhe në situatën financiare të korporatës duke dhënë efekte pozitive edhe në shërbimin borxhit, sidomos të pozicionin e detyrimeve financiare afatshkurtër. Kjo ndihmuar edhe nga Kredia e BERZH në kuadër të ristrukturimit të borxhit afatshkurtër, i cila u disbursua totalisht gjatë 2020, i cili dha efekte pozitive edhe gjatë 2021:

Tabela 9. Overdraftet dhe Normat e Interesit 2016-2021

Ovderdrafet dhe Normat e Interesit	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Mesatarja 5-vjeçare (2016-2020)
Totali i Huave të b.vlefshme ('000 Lekë)	4.974.131	7.312.205	18.472.341	17.441.694	33.914.199	31.988.576	21.825.803
Norma Mesatare e Interesave	3,19%	3,22%	2,79%	2,88%	3,63%	3,97%	3,82%
Shpenzimet për Interesa ('000 Lekë)	158.891	377.020	516.084	772.792	1.229.634	1.268.961	832.898

Referuar tabelës së mësipërme, Efekti vjetor në uljen e kostove të shërbimit të borxhit për vitin 2021 krahasuar me 2020 në zbutjen e interesave afatshkurtër rezultoi në mbi 218 Mln. Lekë. Ndërkohë, Norma Mesatare e Interesave me bankat e nivelit u ul lehtësisht në 3.19% në 2021, krahasuar me 3.22% në 2020.

Edhe në aspektin fiskal, gjatë 2021 vërehet një performancë pozitive, pasi Korporata po përmbush me sukses detyrimet ndaj fiskut, duke kontribuar me sukses në buxhetin e shtetit:

Tabela 10. Shlyerja e detyrimeve tatimore 2016-2021

Pagesat e Detyrimeve Tatimore ('000 Lekë)	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Mesatarja 5-vjeçare (2016-2020)
TVSH paguar te tatimet	2.094.275	780.351	2.465.257	2.256.907	657.553	350.414	1.302.096
Tatimi fitimi	1.563.342	1.766.673	2.629.879	2.343.988	1.265.347	876.071	1.776.392
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	344.107	302.049	274.126	253.902	229.462	258.230	263.554
Taksa dhe Tatime të tjera	6.511	824	6.116	3.934	323.967	1.252	67.218
TOTAL	4.008.235	2.849.897	5.375.378	4.858.731	2.476.328	1.485.967	3.409.260